

PËRFAQËSIMI DHE NXITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE TË NDRËVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT, DUKE NXITUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFIJVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHTETET KU ATA BANOJNË

Takim me Grupin e Koordinatorëve për zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës




U zhvillua takimi i radhës së Grupit të Koordinatorëve për zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës. Në këtë takim, të kryesuar nga ministri i Shtetit për Diasporën, Grupi i Koordinatorëve u përfaqësua vetëm në nivel zëvendësministrash nga ministritë e linjës dhe përfaqësues të Agjencisë Kombëtare të Diasporës. Anëtarët e Grupit, përfshirë përfaqësuesit nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministria e Drejtësisë, diskutuan për publikimin e Buletinit Mars 2020, shkollën verore dhe mbi disa problematika të tjera lidhur me zbatimin e masave të Planit të Veprimit.

QBD-ja shtyn Takimin e Mësuesve të Diasporës



Qendra e Botimeve për Diasporën ka njoftuar se për shkak të situatës së krijuar në vend nga Covid-19, Takimi i Mësuesve të Diasporës, i cili ishte planifikuar për t'u zhvilluar në datën 14 mars është shtyrë. Në ditët në vijim QBD-ja do t'ju njoftojë për datën e re të zhvillimit të kësaj veprimtarie.

Aplikacioni informues "Diaspora Shqiptare"



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

"Raporto" problemin në çdo kohë në Ambasadalme



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

COVID-19 RREGULLAT E REJA

- Ndalohen aktivitetet sportive, kulturore, konferenca, koncerte, tubime dhe dëgjesa publike deri me datë 3 Prill
- Mbyllen diskot, lokale nate, ambiente për argëtim, si qendra sociale, palestra, pishina deri më 3 Prill
- Restorantet, baret të ofrojnë shërbime për qytetarët duke respektuar distancën prej së paku 2 m nga tavolinat dhe së paku 1 metër qytetarët nga njëri tjetri.
- Pezullohen të gjithë procedurat për konkurser për procedurat për punësim
- Mbyllen çerdhet dhe institucionet arsimore deri më 23 Mars
- Ndalohet grumbullimi i pacientëve, shoqëruesve dhe familjarëve në qendra shëndetësore/spitale ku bëhen vizita ambulatorore.
- Kufizohet lëvizja e udhëtarëve me mjetet e transportit publik qytetas, rrethqytetas dhe ndërqytetas për periudhën deri në 3 prill 2020
- Ndalohen lëvizjet e udhëtarëve me mjetet e transportit ajror dhe detar drejt Italisë.

Për të parandaluar përhapjen e koronavirusit në vend: KORONAVIRUS

- Pezullohen fluturimet dhe udhëtimet në rrugë detare me veriun e Italisë, me të gjithë zonat e kuqe të izoluar plotësisht deri më datë 3 Prill.
- Mbyllen institucionet arsimore për një periudhë 2 javore.
- Anulohen grumbullimet masive, aktivitete sportive, kulturore, konferenca, dëgjesa publike deri më datë 3 Prill.
- Vetë-karantinim i detyruar për personat që vijnë nga zonat me shpërrthime komunitare, zonat e kuqe, i cili do të monitorohet me rigorozitet nga strukturat shëndetësore. Ky vendim është i shoqëruar edhe me masa administrative për këdo e thyen këtë rregull.

Për të kontribuar në ndihmë të familjeve të prekura nga tërmeti



Kontributet vullnetare dhe ndihmat për familjet, mund të bëhen me shpejtësi në rrugë digjitale, në tre kategoritë e veçanta të hapura për grumbullimin e ndihmave në portalin "e-Albania".

KKD / Brikena Muharremi pjesë e aktivitetit në Parlamentin Britanik



Avokatja shqiptare në Britaninë e Madhe, Brikena Muharremi mori pjesë në veprimtarinë e zhvilluar në Parlamentin Britanik në Londër me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas. Muharremi, përmes një postimi në rjetet sociale bëri të ditur se në fjalën e saj tregoi për përvojën si avokate, si drejtuese e Shoqatës së Avokatëve Shqiptaro-Britanik dhe për rolin e saj si përfaqësuese për Britaninë e Madhe në Këshillin Koordinues të Diasporës. "Arritja e barazisë gjinore në shoqëri dhe mbrojtja e të drejtave të viktimave të krimit është obligim i yni si qytetarë dhe si profesionistë", është shprehur ajo.

Gazmend Kapllani flet për "Zërin e Amerikës" rreth programit të Katederës së Albanologjisë në Univeristetin DePaul në Çikago



Për herë të parë në historinë e universiteteve amerikane, nga shtatori i këtij viti do të fillojë punën Katedra e Albanologjisë në Universitetin DePaul në Çikago. Drejtori i kësaj katedre dhe njëkohësisht anëtar i Këshillit Koordinues të Diasporës, Gazmend Kapllani, tregon për "Zërin e Amerikës" se krijimi i saj shënon një moment të rëndësishëm në historinë e studimeve shqiptare. Sipas tij, fushat e studimit të përfshira në këtë katedër do të jenë gjithëpërfshirëse. "Do kemi të gjitha disjplinat nga gjuha, letërsia, historia, arkeologjia, filozofia. Dhe duam që të krijmë një kurrikulë sa më bashkëkohore sepse Albanologjia ka mundësi të jashtëzakonshme sidomos kur lidhet me çështje që janë në qendër të diskutimeve globale sot, qoftë për letërsinë e diasporës, qoftë për historinë dhe gjeostrategjinë, qoftë për fënë", - shprehet Kapllani.